



Përse etikës i duhet Islami

Description

Ovimir Anjum

[Kjo ese përpiqet të ofroj një kontribut në përpjekjet e myslimanëve bashkëkohorë për t'i bazuar zgjedhjet e tyre të jetës në një kuptim të thellë të së drejtës dhe të gabuarës, etikës ose akhl?k-ut, dhe për t'i rrënjosur ato standarde etike në udhëzimin e shpallur. Ky synim është veçanërisht urgjent në një botë të dominuar nga konsumizmi laik dhe kënaqësia e menjëhershme. Eseja përpiqet ti kthej përgjigje pyetjeve nëse kemi vërtetë nevojë për shpalljen hyjnore për të qenë të mirë? A janë rregullat e vjetra të jurisprudencës Islame (fikhut) thjesht norma të vjetruara dhe pse nuk duhet të ndjekim vetëm atë që duket e drejtë sipas standardeve bashkëkohore? Të gjitha këto burojnë nga grupi më i përgjithshëm i pyetjeve rreth natyrës dhe qëllimit të jetës dhe si e përkufizojmë të drejtën dhe të gabuarën në radhë të parë. Si besimtarë në premtimin e hyjnor për një jetë të përtejme pakrahasueshmërisht më të rëndësishme se dynjaja, besimtarët myslimanë e dinë se ritmet morale të veprimeve të tyre në këtë dynja jehojnë në përjetësi. Prandaj, kuptimi i saktë i themelit dhe drejtimit të etikës së tyre është thelbësor për të përcaktuar jo vetëm sjelljen e tyre në këtë botë, por edhe destinacionin në botën tjetër.

Siç do të vihet re, për nga natyra e saj, eseja është shkruar në një stil pastoral i cili ndonëse i drejtohet kryesisht një audience myslimanë është shkruar në një formë të tillë që të përfshij edhe një arsyetim publik ku çdokush, mysliman ose jo, është i ftuar të bëhet pjesë e tij. Eseja përmban, po ashtu, dukshëm një ton kritik ndaj gjendjes aktuale të botës dhe njerëzimit. Në përputhje me elementin profetik të kritikës të strukturave ekzistuese, autori përpiqet të ofroj një një korigjues profetik ndaj gjendjes aktuale të njerëzimit.]

Në këtë ese prezantojmë se si:

- *Thënia profetike se ai ishte dërguar “vetëm për të përsosur tiparet e fisme të karakterit” konfirmon përvojën tonë empirike se ndonëse impulsi etik – dashuria për të mirën – është i natyrshëm për të gjithë njerëzit, ne kemi nevojë për shpalljen për ta udhëzuar dhe përsosur atë.*
- *Mospajtimi dhe pështjellimi lidhur me qëllimin dhe natyrën e karakterit të mirë janë të kudogjendura, dhe besimet etike të kequdhëzuara kanë frymëzuar ligësitë më të makthshme të historisë njerëzore.*
- *Moderniteti sekular, i cili pretendon se ofron etikë pa revelatë, është përpjekur që të “kontrabandojë” në vlerat fetare, por ka dështuar që t’u japë kuptim individëve dhe të prodhojë vetë-përmbajtje kundër shfrytëzimit. Kriza e sotme ekologjike është një verdikt i pakundërshtueshëm kundër etikës hegjemonike moderne të kapitalizmit, sekularizmit, dhe liberalizmit, dhe, kësodore, alternativa islame është doemos e nevojshme.*
- *Normat e shpallura hyjnisht konfirmohen dhe përforcohen nga refleksionet etike racionale.*
- *Të mos e pranosh Krijuesin dhe mos të jesh mirënjohës ndaj Tij është një dështim etik madhor.*

Hyrje

Është e gabuar që të thuash gënjeshtër, të torturosh kafshët, dhe të vrasësh apo të lëndosh njerëz të pafajshëm. Është gjë e mirë të jesh i sjellshëm dhe bamirës, mirënjohës, i guximshëm, i duruar, i drejtë, dhe i urtë. Këto parime quhen etikë apo moral dhe në Kuran dhe në mësimet peygamberike përmenden si *huluk* (njëjës) apo *ahlak* (shumës).

Të gjitha kulturat njerëzore i njohin virtytet dhe tiparet e mira në njëfarë trajte elementare. E megjithatë, si në situatat e jetës reale ashtu mbas reflektimit të metjshëm, njerëzit fillojnë të bien në mospajtim lidhur me atë që është e mirë. Ka nga ata që i japin përparësi mëshirës në raport me drejtësinë, ose anasjelltas. Ka nga ata që predikojnë faljen dhe pacifizmin karshi të gjithëve, madje edhe (apo veçanërisht) në raport me njerëzit e pushtetshëm e të fuqishëm. Të tjerë luftojnë për barazi, madje edhe në qoftë se kjo kompromenton lirinë, ose e anasjellta. Të tjerë parapëlqejnë të zgjedhin jetën. Të tjerë betohen për parimin e maksimizimit të lumturisë së matshme. Të tjerë akoma besojnë vetëm në plotësimin imediat të kënaqësive në një botë plot pasiguri. Në vend se të na pajisë me një ngrehinë solide të imperativëve etikë, shtypa etike e përbashkët njerëzore tretet në afshin e diversitetit dhe mospajtimin njerëzor që në dukje janë të pafunda. Për të ndërlikuar punët edhe më tej, bota nuk është një muzeum apo një dhomë seminari për diskutim, por një fushëbetejë ndërmjet të mirës dhe të keqes, dhe flamurtarët e të keqes përherë orvaten që të konvertojnë, dominojnë, dhe t'ua hedhin sy për sy të tjerëve, të nxitur kësisoj prej lakmisë, krenarisë, dhe adhurimit të vetes, duke kalbëzuar kësodore dëshirat tona, perceptimin tonë, madje edhe gjuhën tonë, duke e quajtur të keqen të mirë, dhe të mirën të keqe. Pra, për të qenë i mirë, nuk është thjesht nevoja që të bësh një zgjedhje intelektuale, por prej nesh lipset një angazhim dhe përpjekje për atë që është e vërtetë dhe e mirë.

Sfidat moderne: imperializmi epistemik dhe ekonomik dhe ndryshimi i klimës

Ka një pyetje që bëhet pareshtur në një botë sekulare: a mund të kemi etikë pa fe? Anketat na tregojnë se përgjigja ndaj kësaj pyetjeje varet nga ajo se kujt po i drejtohet pyetja: për pjesën më të madhe të njerëzimit, të cilët janë edhe të skamur edhe fetarë, në masën dërrmuese përgjigja është jo. Për atë pakicë të pasur e të sekularizuar, apo të cilëve iu është shpëlarë truri nga regjimet agresive sekulare, zakonisht përgjigja është po.^[1] Stilet etike të njerëzve janë gjithashtu të ndryshme. Njerëzit e pasur të Veriut global janë më të mirë në atë që ne mund ta quajmë moral korporativ: bëhet fjalë për ato aftësi ndërpersonale të cilat janë të domosdoshme për të funksionuar në organizata të ngritura nga njeriu, sikurse janë përpikmëria në kohë, të thënit e të vërtetës, dhe transparenca (në përputhje me nevojat e shoqërisë manaxheriale), pikërisht sikurse njerëzit tradicionalë ia dalin mbanë më mirë në virtytet familjare dhe të bashkësisë, si altruizmi, nderimi i lidhjeve prindërore dhe fisnore, si dhe shpirtmadhësia. Krahas kësaj, njerëzit që rrojnë në rajone të rrënuara nga kolonializmi dhe nga rende ekonomike dhe politike të dështuara ka të ngjarë që të kenë kompromentuar qëndrimin etik për shkak të mirëbesimit të ulët, cinizmit, dhe nevojës për mbijetesë.

Mirëpo, anketa të tilla lidhur me etikën mbajnë fshehur të vërteta vendimtare e strukturore. Së pari, padronët mbikëqyrës sekularë të botës kanë modifikuar, dhe nuk reshtin së modifikuari, atë çka llogaritet si e mirë, dhe perceptimet e masave shpeshherë marrin trajtë prej propagandës. Vetëm një shekull më parë, fjala bie, t'u shërbeje prindërve do të kishte qenë e cilësuar universalisht si një ndër virtytet etike më të rëndësishme në mbarë botën nga Europa e deri në botën islame e më tutje në Kinë e Indi. Sot, shoqëritë liberale sekulare e kanë flakur tutje këtë virtyt, në mos e kanë kthyer atë në ves. Lakmia, në mënyrë të ngjashme, ka qenë pranuar kahmot si ligësia më e madhe, dhe forma e saj e veçantë, kamata apo interesi, ka qenë krimi më i urryer në të gjitha kulturat dhe në të gjithë historinë, derisa kapitalizmi modern filloi ta cilësonte atë qoftë si virtyt qoftë si domosdoshmëri.^[2] Kjo përshfaq një problem më të thellë se sa shfrytëzimi ekonomik dhe pabarazia në rritje: nga elitat është

manipuluar masivisht edhe vetë sensi ynë për të drejtën dhe për të padrejtën. Këtë unë e quaj *imperializëm epistemik* – kolonizimi i prodhimit të dijes, kuptimit, dhe vlerave nga ana e disa institucioneve globale kyçe. Që kur globalizmi ngrii kryet në vitet 1980, këto institucione nuk janë thjesht “Perëndimore”, por janë zgjeruar duke përfshirë dhe elitën “globale” ultra të pasur në Jugun global, duke i dhënë formë kështu një aleance kundër shumicës së njerëzve çdokund.

Debatet mbi etikën dhe ideologjitë kanë prirjen që të jenë të pafunda. A ka vallë një mënyrë shkencore dhe empirike për të gjykuar sjelljen e padronëve mbikëqyrës të suksesshëm të botës, pra të Veriut global modern, sekular, demokratik, dhe të kamur? A duhet të rrimë e të presim për amshimin, kur do të jetë tejet vonë për ndryshim, për të parë se kush ishte në anën e duhur? Besimi është pjesë e sprovës, kështu që, në njëfarë kuptimi, po, por, prej mëshirës së Tij, Zoti dërgon sinjale. Nuk është pa ironi se shenja më e madhe e falimentimit moral të stilit sekular modern të jetesës ofrohet nga vetë shkenca empirike moderne: bëhet fjalë për ndryshimet klimatike. Le të marrim në shqyrtim një shembull. Ka shumë stile të prindërimit: tradicional dhe modern, autoritar, të shkujdesur, autoritarist, me prirje atashimi, apo me disiplinë të fortë. Por le të përfytyrojmë nëse prindërit shesin dhe konsumojnë të vetmen shtëpi ku mund të jetojnë fëmijët e tyre, çdo tullë dhe çdo orendi e mobilje, qëllimisht dhe prej lakmisë së pafre, duke i lënë të vegjlit e tyre të vuajnë urie, të lypin, dhe të ngrijnë nga i ftohti rrugëve teksa ata konsumojnë gjithçka me babëzi. Të gjitha palët bien dakord se ky përnjëmend është një stil i urryer i prindërimit. Shkenca na thotë se stili modern, sekular, dhe kapitalist i jetesës ka qenë për botën pikërisht ky lloj prindi. Një batore e pafund artikujsh, librash dhe dokumentarësh shkencorë evidenton për kolapsin e ardhshëm mjedisor. Si profesor universiteti që herë pas here mbaj leksione mbi etikën ambjentaliste, unë e filloj kursin me tre fakte që ndihmojnë për ta parë tablonë të plotë:

(1) Që nga Revolucioni industrial i shekullit të nëntëmbëdhjetë, brenda 200 viteve, njerëzit kanë konsumuar pothuajse të gjitha lëndët djegëse fosile për të cilat janë dashur procese natyrore prej mëse 200 milionë vitesh deri në depozitimin e tyre në tokë, dhe, brenda kësaj periudhe, indikatorët e karbonit atmosferik, shpyllëzimit, dhe zhdukjes së specieve kanë marrë të gjitha një formë të paqëndrueshme tëposhtëze;[\[3\]](#)

(2) sipas një vlerësimi të kursyer, pothuajse 5% e popullsisë së botës konsumon 35% të burimeve të botës,[\[4\]](#) gjë që do të thotë se nëse ne të gjithë do të jetonim si perëndimorë modernë, 80% e njerëzve në tokë do të kishin nevojë për një planet tjetër, kështu që moderniteti sekular është udha drejt shfarosjes masive të popujve, rajoneve, dhe kulturave të tëra;

(3) dhe jo, fajtori kryesor nuk është rritja e popullsisë, por mënyra e jetesës. Për ta kuptuar këtë, duhet të vërejmë se duke filluar që nga viti 1890 popullsia botërore u katërfishua gjatë një shekulli, por përdorimi i ujit u rrit nëntë herë, ekonomia botërore 14 herë, dhe përdorimi i energjisë 16 herë.[\[5\]](#)

E gjitha kjo nënkupton se moderniteti sekular – të mos harrojmë se shekulli i nëntëmbëdhjetë është

pikërisht koha kur popullsitë perëndimore filluan të përqafonin vlerat moderne – e ka vrarë planetin Tokë. Madje edhe teksta masat e skamura të botës, përfshirë dhe shumicën e myslimanëve, janë nën trysni për t'u modernizuar dhe sekularizuar, shkencëtarë dhe studiues të dorës së parë po sugjerojnë, me kaq shumë fjalë, se etika tradicionale, komunale, dhe altruiste që ata po e hedhin pas shpine është e domosdoshme për mbijetesën e njerëzimit.

Kjo është vetëm historia e humbjes materiale të kësaj toke: ne madje as nuk e kemi cekur problemin më të thellë të humbjes së besimit në Zot, krizat shpirtërore dhe psikologjike, apo qoftë edhe vetë kuptimin e jetës dhe të mirësisë. Sikurse ka premtuar Allahu i Lartësuar në Kuran, këto të dyja janë të lidhura me njëra tjetrën: “Cilido që heq dorë nga përkujtimi Im, atij jeta ka për t’iu ngushtuar; dhe Ne kemi për ta ringjallur atë të verbër në Ditën e Kijametit” (20:124).

Pyetje etike

Shfryrja e pretendimeve të progresit modern dhe të imperializmit epistemik të botës sekulare na lejon që të çmojmë nevojën urgjente për etikën islame. Nuk është nevoja që të jesh mysliman besimtar që të pikasësh nevojën për një alternativë ndaj sketërrës së modeleve hegjemonike të sotme. Si mund ta përcaktojmë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë? A janë normat etike, si “vrasja e një njeriu të pafajshëm është e padrejtë” dhe “të ndihmosh një nevojtar është gjë e mirë”, thjesht norma konvencionale që e bëjnë më të lehtë jetën tonë (dhe prandaj, nuk kanë themel objektiv), apo janë ato të bazuara në vetë natyrën e gjërave (aq sa ato mund të njihen vetëm nga arsyeja), apo mos janë ato të atribuara dhe të shpallura arbitrarisht nga Zoti (dhe prandaj, të njohshme vetëm nëpërmjet revelatës)? Këto quhen pyetje meta-etike. Dijetarët myslimanë, sikurse kemi për ta parë më poshte, i kanë debatuar këto çështje dhe kanë adaptuar variante të çdonjërës prej këtyre përgjigjeve, por gjithmonë janë përqendruar në shpalljen hyjnore.

Më pas, kemi dhe pyetjet se si etika është e organizuar në një sistem të prioriteteve. Cilat prej sjelljeve dhe virtyteve të shumta të dëshiruara janë më të rëndësishme se sa të tjerat, dhe çfarë na ngelet që të bëjmë kur ato bie ndesh me njëra tjetrën? Në këtë pikë, të gjithë myslimanët bien dakord se është e drejta e Zotit që këtë sistem ta përkufizojë në ligj – thënë ndryshe, Sheriat.

Më të luhatshme dhe të larmishme janë përgjigjet ndaj pyetjeve të pedagogjisë etike, ajo çka myslimanët e quajnë *terbije*. Cila është mënyra e duhur për të përfutur apo mësuar virtytet e dëshiruara: dashuria apo frika? Të rritesh nga prindër që e duan fëmijën në mënyrë të pakushtëzuar, apo disiplina e ashpër nga kujdestarët diskriminues? Refleksioni filozofik i urtarëve, apo këshillat e njerëzve më të suksesshëm dhe më të pushtetshëm? Shkulmi i betejës apo qetësia e librisë?

Megjithatë, më e rëndësishmja nga të gjitha është çështja e qëllimit apo teleologjisë. Cili është qëllimi përfundimtar i jetës, dhe, së këndejmi, i sjelljes individuale dhe jetës sociale? A është qëllimi që të maksimizohet kënaqësia dhe liria individuale, fuqia e grupit për hir të dominimit, apo të kënaqësh Zotin? Pavarësisht nga përgjigja ndaj kësaj pyetje madhore, ata të cilët reflektojnë mbi natyrën e të mirës dhe vihen në kërkim të saj kanë të ngjarë të jenë njerëz më të mirë dhe kanë më tepër të ngjarë që ta arrijnë atë që është e vërtetë dhe e mirë. Duke na bërë ne më të mirë, dhe njerëz më të bukur, refleksioni etik ka fuqinë për të shkuar madje edhe matanë propagandës, sektarizmit, dhe paragjykimit

të kulturave ku kemi lindur. Ata të cilët ishin të dhënë mbas refleksionit të thellë etik qenë të parët që hynë në Islam dhe qenë më të mirët prej myslimanëve.

Kjo ese prezantuese mbi etikën islame është një kundërpërgjigje në tri pjesë ndaj pyetjeve të sipërpërmendura. Së pari, unë paraqes deklaratën kyçe pejgamberike që i jep trajtë themelit të qasjes së adoptuar në këtë seri artikujsh [artikulli është pjesë e një serie botimesh që fokusohen mbi etikën islamike, sh.p,]. Më pas, unë tregoj se si reflektimi filozofik mbi etikën shpesh ka çuar drejt burimit të saj, drejt Zotit Fuqiptotë, por gjithashtu në limitet e racionalitetit dhe në nevojën për udhëzim hyjnor. Së fundi, unë tregoj se si Islami jo vetëm që është në harmoni me arsyen, por gjithashtu kërkon prej nesh që të zhvillojmë kuptim racional mbi sjelljen e mirë si pjesë e udhëzimit të tij holistik.

Ja se si Pejgamberi i Begatuar i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, e ka përmbledhur misionin e tij në tërësi, sikurse përcillet me autoritetin e Ebu Hurejres:

Unë jam dërguar vetëm për të përsosur tiparet e fisme të karakterit.[\[6\]](#)

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, afirmon në këtë thënie të mahnitshme se njerëzit i njohin dhe i zotërojnë tashmë tiparet fisnike; shpallja ka ardhur vetëm për t'i plotësuar dhe për t'i përsosur këto tipare. Fraza ekskluzive “*innema*” mund të interpretohet në dy mënyra, dhe të dyja ato janë të sakta:

- “Unë kam ardhur jo për të shpikur, por vetëm për të përsosur karakterin e mirë.”
- “Unë nuk kam ardhur për asnjë qëllim tjetër përveçse që të plotësojë tiparet e fisme të karakterit.”

E para do të thotë se njerëzit shpesh kanë njohuri për karakterin e mirë dhe e çmojnë atë, disa më shumë se sa të tjerët, madje që përpara se t'u ketë ardhur në dorë revelata. Kjo konfirmohet nga tekste të tjera të shumta të shpallura, si edhe nga evidencat racionale dhe vëzhgimi empirik. Ky kuptim konfirmohet më tutje edhe nga një transmetim në të cilin Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, mbasi takohet me el-Ashaxhin nga fisi i Abdyl Kajsit, i cili kishte ardhur për të përçafuar Islamin, i tha: “Ti ke dy tipare që Zoti i do, vetëpërmbajtjen (*hilm*) dhe butësinë (*enat*).” Padyshim si inteligjent që ishte, bashkëbiseduesi kërkoi të mësonte më tepër: “O i Dërguari i Zotit, këto tipare a janë që unë i praktikoj apo mos vallë Zoti i ka bërë ato në natyrën time?” Pejgamberi i tha: “Tamam tamam, është Zoti Ai që t'i ka dhënë ato ty nëpërmjet natyrës.” El-Ashaxhi shpërtheu në fjalë plot mirënjohje: “Lavdi Zotit i Cili më ka dhënë mua tipare që janë të dashur tek Allahu dhe i Dërguari i Tij!”[\[7\]](#) Ky hadith shpjegon më tutje se tipare të caktuara u janë dhënë si natyrë nga Zoti disa njerëzve më tepër se ta të tjerëve, dhe se të tjera tipare mund të përftohen nëpërmjet edukimit dhe përgatitjes. Një tjetër hadith thotë: “Njerëzit janë si xeherorët, më të mirët sosh në kohën para islamit janë më të mirët në Islam, për aq kohë sa ata janë të mburjtur me kuptim.”[\[8\]](#) Ibn Haxheri, në shpjegimin e tij, vë në dukje tre dimensione të këtij hadithi: karakterin fisnik, i cili është natyra e qëndrueshme e dhënë nga Zoti (prej këndeje vjen dhe referimi ndaj xeherorëve), pranimi i Islamit, ku shtrihet sukcesi i mbramë, si dhe

përpjekja për të përfutur dije rreth fesë. Njerëzit më të mirë janë ata të cilët i zotërojnë të trija këto, por në qoftë se një njeri e refuzon Islamin, të gjitha dhuntitë e tjera bëhet të kota. Me besim, të gjitha dhuntitë e natyrshme feksin deri aty saqë njeriu bën çdo përpjekje për të përfutur dije dhe kuptim rreth revelatës.^[9] Atyre që refuzojnë besimin nuk ka gjë që t'u bëjë dobi, pavarësisht se sa i ngritur është karakteri i tyre dhe sa bamirëse janë veprat e tyre, përndryshe: “Një similitudë e atyre që nuk besojnë në Zotin e tyre: Veprat e tyre [të mira] janë si hiri që era e flak tutje në një ditë të stuhishme; ata nuk kanë në kontroll asgjë prej asaj çka kanë fituar. Ky është dështimi i plotë” (14:18).

Edhe kuptimi i dytë po ashtu është i saktë duke qenë se qëllimi më parësor i misionit të Pejgamberit, adhurimi i Krijuesit dhe Bamirësit të vërtetë, është gjithashtu virtyti më i madh, sikurse është një shprehje e mirënjohjes ndaj Krijuesit dhe pranimi i të vërtetës, dhe nuk ka padrejtësi më të madhe se sa të refuzosh shenjat e Zotit (6:21, 32:22). Në këtë mënyrë, misioni i tij, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, nuk ishte asgjë tjetër vetëm se të përsoste virtytin.

Thënë përmbledhtazi, Islami i përsos tiparet morale në tri mënyra:

- 1) duke u dhënë këtyre virtyteve qëllimin e duhur apo teleologjinë, që është Allahu më i Lartësuari;
- 2) duke ofruar një rrafsh më të lartë dhe jetëgjatë të motivimit; dhe
- 3) duke ofruar kuptimin dhe barazpeshën e duhur në mesin e vlerave konkurruese me anë të Ligjit të shpallur, apo Sheriatit.

Filozofia dhe kufizimet e saj

Jeta pa hulumtim nuk është e denjë për t'u jetuar, ka thënë Sokrati, i cili nga shumëkush besohet se ka qenë i pari filozof etik. Jeta e mirë është një jetë e harxhuar në njohjen, të dashurit, dhe kërkimin e të mirës morale. Filozofikisht, etika universale (domethënë, ideja se të gjithë njerëzit kanë disa të drejta) dhe monoteizmi (besimi se të gjithë njerëzit kanë një Zot suprem) e presupozojnë fuqimisht njëra tjetrën. Le të shqyrtojmë thënien se “një jetë pa hulumtim nuk është e denjë për t'u jetuar”. Ajo në vetvete është thjesht një pretendim: a nuk është e denjë jeta e bimëve të fierit, e buburrecave, apo e fluturave? Ajo çka e bën të mundur dhe të domosdoshme këtë pyetje lidhur me natyrën dhe qëllimin e jetës është vetë aftësia jonë për të reflektuar, për të vënë në peshore, dhe për të gjykuar. Por prej nga vjen kjo aftësi? Prej nga vjen vetë jeta? Sokrati nuk ishte i vetëm; shumëçka prej të filozofuarit njerëzor në kohë dhe hapësirë tregon për kërkimin njerëzor për të njohur përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve. Por Sokrati, dhe të tjerët si ai, pavarësisht se ishin brilantë, nuk mund të shkonin dot përtej *mendimit* të tyre për një Zot të vetëm, ose drejt *adhurimit* të Zotit një e të vërtetë ose drejt etikës së baraspeshuar dhe të realizueshme. Mos harroni se ishte Sokrati ai i cili la të kuptohet, në *Republikën* e famshme të Platonit, se gjithçka duhet të qeveriset nga një filozof i gjithë-ditur, dhe se gratë dhe fëmijët duhet të jenë pronë e përbashkët dhe jo individë brenda familjeve të tyre, se fëmijët duhet të ndahen nga

prindërit e tyre që në lindje dhe të vendosen diku në bazë të kapaciteteve të tyre natyrore në mënyrë që të mos marrin dashuri të pamërituar, dhe kështu me radhë, duke propozuar faktikisht, kësodore, një plan për shoqërinë më raciste dhe më pa dashuri që imagjinata mund të rrokte.[10] Si ka mundësi vallë që njeriu i cili njihet si filozofi i parë dhe më i madh i etikës të dalë në një konkluzion që, ngado që ta marrësh, shpërfaqet si më i i mjeruari dhe më joetiku? Sepse mendjes njerëzore, madje edhe në kulmin e saj, nuk mund t'i kesh besën e ta lësh të jetë perëndi; vetëm Zoti është i pastër nga zonat e skëterrëta dhe gabimet. Ç'është e vërteta, njerëzit e njohin intuitivisht papërsosmërinë e vet dhe kanë një etje të pashueshme për të kërkuar atë çka është pafundësisht e mirë dhe e përsosur. Ne të gjithë jemi në kërkim të Zotit, madje edhe kur nuk e dimë këtë.

Çdo libër tipik mbi historinë e etikës thotë se disiplina filozofike e etikës lindi në Greqinë e lashtë pikërisht për t'u marrë me llojet e pyetjeve që ne kemi renditur sa më sipër. Por ama kjo nuk është tjetër vetëm se një narrativë sekulare dhe eurocentrike: njerëzimi kurrë nuk ka ekzistuar pa udhëzim hyjnor dhe, prandaj, as pa etikë. Allahu e krijoi njeriun e parë me aftësinë për të dalluar të mirën nga e keqja dhe për të pikasur imperativin e ndjekjes së udhëzimit hyjnor kur ai dërgohet nëpërmjet pejgamberëve hyjnorë. I Plotfuqishmi iu drejtuar atit tonë, Ademit, me këto fjalë: “Kur ty të vjen udhëzimi prej Meje, cilido që ndjek udhëzimin Tim, për atë nuk ka për të patur frikë, dhe ai as nuk do të pikëllohet” (2:38). Këtu mësojmë se udhëzimi hyjnor nuk u dërgua kuturu apo mbasi eksperimenti njerëzor mori për shtrembër, por ama që nga zanafilla ka qenë pjesë e planit hyjnor. Duke e pasur parasysh këtë, njerëzimi nuk ka jetuar kurrë pa hajrin e udhëzimit hyjnor. Megjithatë, njerëzit ndahen në dy lloje: ata që janë të begatuar sikurse ymeti i Pejgamberit të mbramë, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, të cilët kanë qasje të qartë në të në trajtë të pandryshuar, dhe ata për të cilët udhëzimi është harruar, përveçse në trajta të shtrembëruara dhe të pjesshme.

Kyçi i atij udhëzimi ka qenë gjithnjë që të pranohet e vërteta e Zotit një që s'bëhet dy, që të adhurohet vetëm Ai, dhe që të tregohemi të mirë me njëri tjetrin. Logjikisht, i Plotfuqishmi mund ta kishte kufizuar fenë e Tij vetëm në adhurimin e Tij, por falë rahmetit dhe urtësisë së Tij, Ai mirësinë ndaj krijimit e ka bërë pjesë të besimit tek Ai, e ka ngulitur në natyrën tonë mirësinë ndaj të tjerëve dhe ndaj gjithë krijimit mbarë, dhe e ka përforcuar këtë nëpërmjet udhëzimit të Tij të shpallur. Por njerëzit janë harrestarë, si individë dhe si komunitete. Historia njerëzore është plot e përplot me cikle të harresës njerëzore dhe përkujtimit hyjnor. Me kalimin e kohës, ai udhëzim do të bëhej i zbehtë, i humbur, ose i njollosur deri në atë pikë sa që njerëzit do të binin në politeizëm dhe shtypje reciproke.

Ne, si rrjedhojë, duhet ta refuzojmë trillin eurocentik se reflektimin etik e shpikën filozofët grekë nga shekulli i gjashtë deri në shekullin e katërt para erës sonë, pasi ka të ngjarë që filozofët paganë grekë, apo ata që patën influencë mbi ta, të kenë patur qasje në disa mbetje të revelatës në po të njëjtën mënyrë sikurse ndodhi kjo edhe me arabët paganë. Dhe pikërisht sikurse ka patur *hanifë* – monoteistë të cilët qenë dhënë pas kërimit të udhëzimit hyjnor – në Arabinë pagane përpara Islamit, disa interpretues dorëlëshuar i klasifikojnë të ngjashmit e Sokratit, Platonit, dhe Aristotelit si disi monoteistë. [11] Evidencat historike lënë të kuptohet se pa denoncuar idhujtarinë (adhurimin e perëndive të shumta) në praktikë, kërkimi i këtyre filozofëve për të vërtetën i çoi ata në *monoteizmin konceptual*. [12] Në mënyrë të ngjashme, filozofët hindu të Upanishadëve, ndërkohë që vijonin të ishin idhujtarë, kishin sinjalizuar se anonin kah monoteizmi konceptual në të njëjtën mënyrë që arabët para-islamikë i kishin atribuar fuqinë e plotë Allahut ndërkohë që e përligjnin idhujtarinë. [13] Kjo do të thotë se ose nëpërmjet mbetjeve të udhëzimit hyjnor ose nëpërmjet të menduarit të tyre të virgjër, njerëzit natyrshëm fillojnë të besojnë në një Realitet të Mbramë, por shpesh nuk mund të avancojnë përtej kësaj pike pa dobinë e marrëdhënies hyjnore, duke kaluar në mospajttime dhe pështjellime të pafund. Ne kemi nevojë për

revelatën për të arritur tek atributet e Zotit Një e të Vërtetë dhe për të gjetur atë rrugë të duhur të jetës që e kënaq Zotin.

Pra, për ta përsëritur, ndonëse arsyeja njerëzore mund të zbulojë të vërtetën e monoteizmit hyjnor dhe të vërtetat etike, ajo ka gjasa që të bjerë në gabim; ajo është më mirë e pajisur, me fjalë të tjera, që të pikasë të vërtetën kur kjo paraqitet, se sa ta njohë atë pa asfarë prezantimi. Imam Ibn Tejmije e shpreh këtë argument duke evokuar Suren Mulk që na tregon për mosbesimtarët të cilët në amshim do të thonë: “Ah sikur të kishim dëgjuar [pejgamberët] apo të kishim arsyetuar, ne nuk do të ishim në mesin e shoqëruesve të Zjarrit” (67:10).^[14] Por në qoftë se njerëzit shpeshherë dështojnë që të pranojnë dhe të falënderojnë Krijuesin e tyre, sa të ngjarë ka që ata të shpërfillin më tepër të drejtat e krijimit të Tij?

Përvoja jonë empirike bashkëkohore i konfirmon të dyja këto vëzhgime: ekzistencën e sensit etik natyror (*fitra*) dhe dobësinë e saj. Madje edhe në jetët tona të hiper-sekularizuara, artificialisht të mekanizuara, të distancuara nga natyra, dhe jo-reflektive, qeniet njerëzore nuk mund t'i shmangin lehtësisht parashtrimin e këtyre pyetjeve “të mëdha”.^[15] Është e pamundur që jeta njerëzore të mos ballafaqohet me këto problematika, dhe zgjedhja jonë është ose t'i përgjigjemi thirrjes së të vërtetës, ose ta shpërfillim atë, ose ta mohojmë atë. Kjo bëhet zgjedhja themelore morale mbi të cilën varet gjithçka tjetër. Megjithatë, ne gjithashtu dëshmojmë se arsyeja njerëzore, kur udhëhiqet nga elita që i shërben vetes dhe jo nga revelata hyjnore, degjeneron ose në mosmarrëveshje të pafunda dhe cinizëm, dhe absurditete si ateizmi, ose në kulte obskurantiste që imitojnë fenë e vërtetë. Përkundër gjykimit kumulativ të të gjitha shoqërive të njohura njerëzore, përfshirë edhe shumicën e njerëzve sot në favor të etikës teiste, një elitë e vogël hegjemonike globale prodhon filozofi dhe kulturë agnostike apo ateiste që refuzon të vërtetën e Zotit, e megjithatë ajo është e gatshme t'iu besojë edhe përrallave më fantazmagorike; si personazhet e *Liza në Botën e Çudirave*, ata praktikojnë besimin në gjashtë gjëra të pamundura përpara çdo vakti mëngjesi.

Pa ligj hyjnor, asnjë vijë që ndan të mirën nga e keqja nuk është përtej kontestimit filozofik. Sjellja homoseksuale, deri së voni, është parë në të gjitha kulturat si imoraliteti më i madh, por sot elita globale ka vendosur për të kundërtën.^[16] Madje ka dhe nga ata që kanë filluar të përlijin incestin. Jo shumë kohë më parë, eugenika dhe teoritë raciste të sjelljes njerëzore që përlijnin dominancën e disa racave dhe kriminalizimin e të tjerave kanë qenë shkencë *mainstream*. A është vrasja e kafshëve (apo edhe e bimëve) për konsum me të vërtetë e ndryshme nga vrasja e njerëzve për konsum? A është me të vërtetë vrasja e foshnjave të padëshiruara moralisht e njëvlershme me vrasjen? Sikurse ka vërejtur filozofi kryesor i moralit i kohës sonë, Alasdair MacIntyre, një i krishterë, në librin e tij shtegshënues *Mbas Etikës* (1984),

Tipar dallues i rendit social dhe kulturor ku ne po rrojmë është se mosmarrëveshjet mbi çështjet qendrore morale janë tipikisht të pazgjidhme.^[17]

Arsyeja, pohon ai, është refuzimi nga mendimtarët e Iluminizmit i themelit fetar monoteist të këtyre vlerave dhe zëvendësimin e atij themeli me “moralin sekular” me të cilin çdo person racional mund të pajtohej. Koncepte që në origjinë ishin fetare, sikurse ishte shenjtëria e jetës njerëzore, barazia fundamentale e qenieve njerëzore përpara Zotit, dhe kështu me radhë, kishin ngelur tashmë jetimë, për shkak se filozofët ndërluftues nuk arrinin të pajtoheshin për një bazë të njëjtë për to. Të gjitha vlerat

në një kulturë të tillë sekulare varen nga ajo çka jep ndjesi të mira apo të këqija, një teori etike kjo e quajtur *emotivizëm*.^[18] Në një kulturë emotiviste, besimet etike bazohen thjesht mbi manipulimin e individëve prej njëri tjetrit, nga njëri krah, dhe i të gjithëve nga forcat më të fuqishme të elitave politike dhe kapitaliste, nga krahu tjetër.

Në Deklaratën e Pavarësisë të Shteteve të Bashkuara, formuluar aq fisëm, Tomas Xheferson tregoi vetëm një gjysmë të vërtetë kur shkroi: “Ne pohojmë se këto të vërteta janë vetvetiu të qarta, se të gjithë njerëzit janë të krijuar të barabartë, se ata janë të pajisur nga Krijuesi i tyre me të Drejta të caktuara të patjetërsueshme, se ndër këto janë Jeta, Liria, dhe rendja pas Lumturisë.” Këto të vërteta nuk kanë qenë asnjëherë vetvetiu të qarta, pasi në eksperiencën njerëzore në çdo drejtim normë është diferenca dhe pabarazia; ideja e barazisë mund të vijë vetëm nga besimi në një shpirt të zbritur nga sipër. Sa herë që ka humbur qasja në revelatë, ka ndodhur shpesh që njerëzit i janë rikthyer ekzistencës shtazarake.

Si i justifikon parimet morale shoqëria perëndimore e post-Iluminizmit, e përkufizuar nga filozofia liberale, të cilën MacIntyre e quan emotiviste? Përgjigja e një studiuesi konstitucional amerikan është veçanërisht e qëlluar: një lloj kontrabande intelektuale. Kjo i ka nxitur disa studiues që t’i akuzojnë ata për kontrabandë të vlerave etike nga fetë e mëdha për shkak se ata nuk kanë një justifikim të vlefshëm të vetin.^[19]

Kjo e vërtetë është shprehur më thukët dhe shumë më herët nga romancieri rus Dostojevski, protagonist i të cilit në *Krim e Ndëshkim* (1866) pasojën e këtij besimi që po lindte në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë e cilëson kështu: “Nëse nuk ka Zot, atëherë gjithçka është e lejuar.”^[20] Në rrëfimin e filozofit gjerman Fridrih Niçe, i cili vetë kishte përjetuar pasojat e humbjes së besimit të tij të krishterë, një i marrë që parasheh Europën e re shpall se çfarë nënkuptonte humbja e besimit në Zot që do të pushtonte më pas Europën:

Si qemë ne në gjendje të pinim detin? Kush na dha shtupën për të fshirë të gjithë horizontin? Çfarë bëmë në të vërtetë kur e zgjidhëm këtë tokë nga zinxhiri që e mbante atë lidhur me diellin e saj?... A ka ende ulje e ngritje? A nuk po endemi sikur të ishim në një asgjë të pafundme? ... Zoti ka vdekur! Zoti mbetet i vdekur! Dhe atë e kemi vvarë ne.^[21]

Me një qartësi karakteristike, Niçe thotë se kur tronditet besimi në Zot, asgjë nuk është më e kuptueshme; bota morale thyhet copash ndonëse njerëzit do të vazhdojnë të mbajnë sytë mbyllur përpara pasojave të saj. “Nuk janë sytë,” thotë Zoti i Gjallë, “por zemrat në kraharorët e tyre që bëhen të verbëra!” (22:46). Zoti është i Gjallë; ajo që është e vdekur në të vërtetë është kultura që shqipton dhe ngre në qiell blasfeminë.

Sekularizmi modern si një politeizëm i vlerave

Një tjetër bashkëkohës i Niçes dhe shumë më tepër *mainstream*, njëkohësisht themeluesi i shkencave sociale moderne, Maks Veber, parashikoi karakterin e epokës së ardhshme dhe, madje edhe si person sekular, nuk mund të rrinte pa u shqetësuar në lidhje me politeizmin e modernitetit. “Vizioni i tij i rimagjepsjes politeiste,” shkruan një studiues për Veberin, “është në fakt ai i një fragmentimi të pakrahasueshëm të vlerave në një pluralitet të meta-narrativave alternative, ku secila pretendon se i përgjigjet të njëjtave pyetje metafizike që feja dhe shkenca janë orvatur të shtjellojnë secila sipas mënyrave të tyre.”^[22] E ashtuquajtura “vdekje e Zotit” ka rezultuar si në një univers të pushtuar nga fantazma ashtu edhe në rikthimin e perëndive dhe demonëve të cilët “orvaten të fitojnë pushtet mbi jetët tona dhe sërish ... rifillojnë luftën e tyre të përjetshme me njëri tjetrin.”^[23] Sekularizmi modern, në dukje ateist apo agnostik, është në të vërtetë në shumë mënyra të qarta një lloj politeizmi.^[24] Teksa monoteizmi ka marrë tatëpjetën në shoqërinë moderne, njerëzit kanë prirjen që të regresojnë në obskurantimzin besëtyt të modës së vjetër, sikurse po bëhet përherë e më e qartë sot.^[25] Njerëzit janë krijuar për të adhuruar, dhe kur ata dështojnë që të pranojnë dhe të adhurojnë Zotin, ata pa dallim bien në adhurimin e perëndive të shumta, përfshirë këtu dhe perënditë e dëshirës dhe të pushtetit. Sikurse thotë i Plotfuqishmi:

A e ke parë atë që dëshirën e vet e ka bërë perëndi të vetën? Allahu e ka çuar atë në rrugë të shtrembër, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën, dhe i ka vënë perde mbi shikim. Pra, kush mund ta udhëzojë atë përveç Allahut? A nuk merrni mësim? (45:23)

Përse shpallja duhet ta udhëheqë etikën tonë? Edhe Hitleri nuk ishte pa etikë!

Fëmijëve myslimanë shpesh iu mësohet se sa të tmershëm kanë qenë arabët para Islamit. Ata nuk kishin virtyte shpaguese. Tekembramja, groposja për së gjalli e foshnjave vajza ishte një praktikë normale për ata! Çfarë mund të jetë më e keqe se kjo? Por kjo perspektivë naive na bën të verbër për faktin se vrasja e fëmijëve ka qenë e zakonshme në shumë shoqëri nën maskime të ndryshme; në disa shoqëri politeiste, fëmijët jepeshin në flijime rituale për hir të perëndive.^[26] Le të lëmë mënjanë për momentin faktin se vrasja dhe shfrytëzimi i popujve jo-perëndimorë, që kurrsesi nuk shihet si një e metë etike, është një tipar i rendit aktual imperial të botës. Në shoqëritë liberale moderne, ku të drejtat e njeriut adhurohen, ka shumë që mbrojnë të drejta të ngjashme për të vrarë foshnje të palindura në emër të lirisë seksuale, zgjedhjes, dhe arsyeve të tjera.^[27] I vetmi dallim i arabëve para Islamit ka qenë se ata ishin teknologjikisht mbrapa dhe se iu duhej që të prisnin që fëmijët më parë të lindnin përpara se t'i vrisnin. Mirëpo, si çdo shoqëri, ata kishin virtyte të shumta: ata praktikonin dhe e çmonin bujarinë, të qenit kavalier, kurajon, dhe kështu me radhë. Pavarësisht nga kjo, të varfërit në gjirin e tyre i varrosnin bijat për së gjalli nga “frika e urisë” (17:31). Ata individualisht mund ta kenë ndjerë se kjo qe krejtësisht e gabuar, por atyre iu mungonte besimi në pacënueshmërinë e jetës të cilën ta jep vetëm Zoti. Shumë shoqëri tribale dhe pagane, për shembull, nuk i mvishnin shenjtëri jetës njerëzore, dhe praktika të tilla si flijimi i fëmijëve, vrasja e të vejave mbas vdekjes së bashkëshortit, dhe i të huajve të cilët hynin në territorin e bashkësisë ishin gjerësisht të përhapura.^[28]

Më përgjithësisht, le të imagjinojmë një shkencëtar, i cili nuk preket nga asgjë përveçse nga argumenti

racional, dhe i cili ka vënë në çdo cep të tokës bomba bërthamore, dhe ti je asistenti i tij i ngratë në anijen e tij kozmike: të ka kapur tmerri nga plani i tij, dhe ke atë dëshirën e fortë të brendshme që t'i japësh disa arsye se pse nuk duhet ta shtypi butonin. I thua se vrasja e të pafajshmëve është gjëja më e tmerrshme që mund të bëhet, kurse ai të kujton se ti nuk e pate aspak problem të shfarosje të gjithë popullsinë e buburrecave që kishe në kuzhinë para një viti. Si është e ndryshme jeta njerëzore në tokë nga prania e buburrecave?

Pyetje të tilla që i përkasin vlerës së jetës njerëzore, apo çdo vlere tjetër morale, nuk mund të zgjidhen filozofikisht. Në mungesë të një autoriteti transhendent, shoqërive njerëzore nuk i ngel tjetër vetëm se të kenë thjesht një opinion. Teoritë moderne të sotme perëndimore të etikës, sikurse e kemi vënë në dukje më herët, janë të bazuara mbi besime dhe koncepte të “kontrabanduara” nga tradita abrahamike – idetë janë kopjuar pa pranuar themelet e tyre. Në Islam, njëjtazi si në shpalljet e tjera të mëparshme, të drejtat e njeriut ishin *hukuk el-‘ibad*, literalisht, të drejtat e robërve të Zotit. Rreziku i një etike të tillë të pabazë si kjo e sotmja, që pluskon në ajër si gjethe e tharë në një ditë me erë, është i qartë kur merren në shqyrtim mizoritë e shekullit të njëzet. Sipas vlerësimeve, miliona njerëz janë vrarë në duart e shteteve moderne, për hir të ideologjive moderne si progresi, marksizmi, dhe kolonializmi, në dy luftërat botërore dhe më pas. Përkundër besimit popullor, pjesa më e madhe e akteve të tmerrshme ndodhin jo për shkak të mungesës së moralit, por më saktë në emër të ndonjë qëllimi që supozohet se është moral.

Hitleri, për shembull, me të drejtë i cilësuar si apoteoza e ligësisë dhe e të keqes në modernitet, shtysën për gjenocid e mori prej angazhimit të tij të fortë ndaj besimeve të tij morale të veçanta. I frymëzuar nga ideologjia e darvinizmit që pat inkurajuar ateizmin, lëvizja eugjenike ishte bërë gjerësisht e pranuar në gjirin e intelektualëve dhe shkencëtarëve të fundshekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimisht të njëzet. Në përputhje me këtë, Hitleri thjesht sa u orvat që të çonte besimet moralo-shkencore në konkluzionin e tyre logjik, gjë që intelektualët dhe filozofët e squllët ishin tejet të dobët për ta bërë.^[29] Në fakt, sikur të mos ishte për zemërimin ndaj masakrave të kryera nga nazistët si rezultat i drejtpërdrejtë i besimeve të tilla dhe sikur të mos ishte për ringritjen e ideve fetare, ide të tilla fare lehtë mund të ishin në modë edhe sot, dhe ka shenja se ato janë në ngritje sërish jo vetëm në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara, por ato janë përhapur në shtete rishtazi të “modernizuara” si Kina dhe India. Rendja pas një të mire etike më të lartë që gjithashtu justifikimi që qëndronte në themel të transformimit komunist të Kinës në vitet 1950, udhëhequr nga Mao Ce Duni. Dhjetra miliona njerëz vdiqën urie në zinë e bukës të fabrikuar nga dora e njeriut gjatë Hapit të Madh Përpara, por një tragjedi e tillë u cilësua e domosdoshme për të arritur një shoqëri më të barabartë ekonomikisht dhe një varfëri të reduktuar në të ardhmen. A mund të argumentojë dikush racionalisht se kjo vrasje masive që e gabuar? A nuk justifikohet ajo prej dominimit global të Kinës dhe popullësisë së saj aktuale prej mëse një miliardë njerëzish? Përse qëllime të tilla nuk i justifikojnë mjetet?^[30]

“Po ISIS-i?” mund të pyesni ju. Kjo strukturë terroriste, lindur nga dy dekada luftë dhe sanksione nga Shtetet e Bashkuara dhe që ekzekutoi e vrau rreth 33,000 njerëz në Irak dhe Siri, kryesisht myslimanë, na ndihmon që ta bëjmë më të qartë argumentin tonë. Veprimet e saj ishin kaq të tmerrshme sa që edhe organizata mëmë e saj, al-Qaeda, e dënoi atë.^[31] Pothuajse të gjithë autoritetet myslimane kanë rënë në një mendje se veprimet e këtij grupi ishin në kundërshtim me Sheriatin.^[32] Asnjë sistem etik nuk mund të përcaktojë veprimet njerëzore. Ajo që ka rëndësi është se pavarësisht nga arsyet që motivojnë grupet terroriste si ISIS-i, të cilat përmbajnë një kombinim të hakmarrjes visherale dhe ideologjive moderne, dhe mbi të gjitha, mungesa e një autoriteti islamik të konstituar nga ymeti siç është kalifi, ajo që ka rëndësi është se myslimanët në masë dërrmuese e pikasën natyrën jo-islame të

taktikave të këtij grupi. Krahasoje këtë me Sekretaren e Shtetit të SHBA Madeleine Albright e cila, kur u pyet për vdekjen e gjysmë milioni fëmijëve si një rezultat i drejtpërdrejtë i luftës dhe sanksioneve ndaj Irakut – kondita këto që qenë drejtpërdrejtë përgjegjëse për krijimin e ISIS-it – tha në televizion me një qëndrim krenar dhe pa iu dridhur qerpiku: “Ne gjykojmë se ky çmim ia vlejti që të paguhej!”^[33] Pak kohë mbas kësaj interviste, Albright fitoi zgjedhjet për një vend në Senatin e SHBA. Me fjalë të tjera, demokracia më e vjetër e botës dhe mbrotjësja e të drejtave të njeriut beson se gjysmë milion fëmijë të pafajshëm myslimanë mund të vriten në mënyrë legjitime për të mbrojtur interesat e saj strategjike. Kjo është historia e liberalizmit sekular e thënë shkoqur.

Duke thënë se për ata të cilët nuk e pranojnë Zotin apo nuk pranojnë një realitet të mbramë nuk ka një bazë të shëndoshë për të shpallur një të mirë morale, unë, dhe filozofët e shumtë të cilët pohojnë këtë pikëpamje, nuk nënkuptoj se njerëz të tillë nuk mund të kenë qëndrim moral apo se nuk mund të kenë ndonjë filozofi morali. Sensi moral, *fitra*, është e dhënë nga Zoti. Dështimi për të pranuar Zotin nuk e eliminon atë; kjo thjesht e përshtjellon dhe e keqduhëzon atë në një miriadë mënyrash. Shkurtimisht, shtypa etike që ne të gjithë kemi na nxit të gjithëve në mënyra krejtësisht të ndryshme, por nëse nuk është e udhëzuar nga e vërteta e Zotit dhe e disiplinuar nga urdhërat e Zotit, ajo shpesh i shtyn njerëzit që të kryejnë mizori më të mëdha se sa ç’mund të kryer ndonjëherë ndonjë kafshë.

E kush mund ta thotë këtë më mirë se sa ai të cilit i është dhënë fjala më elokumente, Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të: “Unë jam dërguar vetëm për të përsosur tiparet e fisme të karakterit.”

Ndjekja e arsyes së drejtë (*fitrije*)

Le t’i kthehemi sërish arsyes, por kësaj here *arsyes së drejtë* që i përgjigjet thirrjes së Zotit dhe të vërtetës, dhe nuk rebelohet ndaj tyre.

Gjëja e parë që zbulojmë pasi reflektojmë, dhe që duhet ta zbulojmë domeos, është se vetëm Ai i cili na ka dhënë jetën mund t’i japë asaj vlerë. Nëse ushqejmë absurditetin se nuk ka një burim të tillë dhe se jeta është thjesht një aksident i verbër, atëherë nuk mund të ketë asnjë vlerë: asnjë bazë për të mirën apo të keqen, asgjë nuk është e drejtë apo e padrejtë. E thënë ndryshe, nëse nuk ka Zot, atëherë nuk mund të ketë as etikë, sepse etika është në themel një ushtrim i përpjekjes për të kërkuar Zotin.

Pra, Zoti është e mira e mbrame. Shpallja hyjnore i plotëson detajet në këtë linjë të natyrshme të të arsyetuarit. Me Zotin që është Krijuesi dhe Mbajtësi i të gjithë jetës, e vetmja jetë që është e denjë për t’u jetuar është ajo që orvatet të gjejë Krijuesin. Krijuesi, dhe ky është mesazhi më qendror i të gjitha feve të shpallura, nuk është një forcë e verbër. Kurrsesi një energji pa emër apo një realitet i palëvizshëm, Ai është një qenie me vullnet, i cili e njeh dhe e ka të dashur krijimin e Tij, dhe e ka të dashur atë që është e mirë. Të gjitha veprat e mira duhet të kërkojnë Zotin, ose përndryshe ato nuk mund të jenë të mira.

Jeta ka vlerë, dhe morali ekziston, për shkak se Allahu i Plotfuqishëm e ka nderuar njeriun, dhe Ai fryn nga fryma e Tij brenda njeriut për të krijuar jetën (Kuran, 15:29; 38:72; 32:9). Në qoftë se vetja nuk

është asgjë tjetër vetëm se frymë, emanacion, dhe dhuratë e Zotit, atëherë çfarë mund ta bëjë atë të lumtur përveç Zotit?

A është urdhëri i Zotit arbitrar apo racional dhe etik? Sheriati urdhëron për mirësi dhe drejtësi

Përshkrimi Kuranor i kumtit të Pejgamberit thekson natyrën rationale të kumtit, për aq sa Zoti na ka urdhëruar të bëjmë atë që natyra njerëzore e njeh si të drejtë dhe dobiprurëse. Zoti ka të drejtën absolute për të urdhëruar atë që Ai dëshiron, dhe Ai pa dyshim i kishte sprovuar bashkësitë e mëhershme me urdhëresa që ishin thesht një sprovë dhe, në vetvete, ato nuk ishin të mira apo të dëshirueshme. Urdhëresa të tilla u hoqën nga Ligji i përkryer që iu dha Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kësodore duke e përsosur atë:

Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” (7:157)

Ky ajet bën deklaratën monumentale se Sheriati që i është dhënë Pejgamberit, s.a.u.s. – standarti i asaj çka është e drejtë dhe çka është e padrejtë përpara Zotit – është i aksesueshëm për natyrën njerëzore, dhe se normë e tij është që të flaken tutje barrat arbitrare dhe që të bëhet e mundur një jetë e mirë.

Më herët ne thamë se dijetarët myslimanë klasikë kanë patur mospajtime lidhur me atë nëse të vërtetat etike janë të aksesueshme nga arsyeja njerëzore pa u ndihmuar nga shpallja. Të gjitha dijetarët bien dakord mbi natyrën e arsyeshme dhe dobiprurëse të urdhërit hyjnor, por kjo mosmarrëveshje teorike ka vlerë që të riprodhohet këtu sa për të na ndihmuar që të kujtojmë se sa thellësisht kanë debatuar dijetarët tanë mbi filozofinë etike në shërbim të shpalljes së Zotit. Nga katër shkollat teologjike, tri prej tyre, tradicionalistët, maturiditë, dhe mutezilitët, kanë argumentuar se të vërtetat etike janë përnjëmend të njohura për arsyen njerëzore, ndërkohë që njëra shkollë, esharitë, nuk kanë qenë dakord me këtë. [34] Esharitë nuke kanë mohuar se arsyeja njerëzore mund të njohë atë që është dobiprurëse apo e dëmshme, por ata e diferencojnë atë nga të diturit se çfarë është e mirë apo e keqe në sensin e të shkaktuarit të shpërblimit apo ndëshkimit prej Allahut në amshim. Për të ruajtur plotfuqishmërinë hyjnore, ata pohojnë se nuk ekziston asnjë rend i të mirës apo të keqes përpara shpalljes së Zotit apo ndaraz prej saj, në të cilën Allahu më i Larti urdhëron dhe ndalon lirisht sikurse Ai dëshiron. Të tjerë thonë se dija që Allahu ka vendosur në natyrën njerëzore dhe e ka bërë të qasshme për arsyen njerëzore është në përputhje me normat e shpallura, ndonëse të gjithë pajtohen se në rastin e mosmarrëveshjes së perceptuar, normat e shpallura të formuluar shprehimisht kanë superioritet të padiskutueshëm. Diferenca, pra, është rezultante vetëm në rastet kur shpallja nuk thotë diçka specifike, dhe këto hollësi janë përtej qëllimit të esesë sonë këtu. Mjaft që të themi që esharitë, si Imam Gazaliu, nuk e vënë në diskutim që normat ligjore islame në formën e Sheriatit janë përnjëmend

dobiprurëse, dhe, kësisoj, racionale. Pra, të gjitha shkollat faktikisht bien dakord që ligji i Allahut është edhe dobiprurës e racional në këtë jetë edhe standarti i suksesit apo dështimit në amshim. Shkolla tradicionaliste përmbledhet fuqishëm nga Imam Ibn Kajimi:

Me të vërtetë, Sheriati është ngritur mbi urtësinë dhe mirëqenien për robërit në këtë jetë dhe në amshim. Në tërësinë e tij ai është drejtësi, rahmet, dobi, dhe urtësi. Çdo çështje që braktisë drejtësinë për tiraninë, rahmetin për zullumin, dobinë për kalbëzimin, dhe urtësinë për marrëzinë, nuk është pjesë e Sheriatit edhe sikur nëpërmjet një interpretimi ajo të jetë bërë pjesë e tij.[\[35\]](#)

Kjo do të thotë se madje edhe përtej urdhërave dhe ndalimeve të Allahut, që rrokin tharmin e të gjithë nimitit dhe ndalojnë tharmin e gjithçkaje që është e ligë, *ulemaja* e zgjerojnë kuptimin racional nëpërmjet analogjisë dhe duke marrë në shqyrtim qëllimet dhe objektivat e ligjit. Ky është areali i jurisprudencës, apo fik'hut.

Por madje edhe përtej fik'hut, ekziston nevoja për të përgatitur qëllimet dhe zakonet nëpërmjet reflektimit të brendshëm, përgatitjes (*terbije*), dhe dëlirësimit të brendshëm (*tezkije*), për reformim të zakoneve, dhe për vlerësim të veprimeve tona në mënyrë që të zgjerojmë aktet e sadakasë që në fik'h lihen si thjesht të rekomanduara apo asnjëanëse.

Allahu në Kuran na urdhëron rreth 200 herë që të “bëjmë vepra të mira: pa specifikuar një formë të veçantë të tyre apo grup marrësish të tyre. Allahu nuk i kufizon “veprat e mira” në kryerjen e një seti urdhërash apo adhurimesh specifike.

Kurani dhe shembulli profetik nuk lënë asnjë shteg për dyshim se ne jemi të inkurajuar që të jemi të mirë me këdo dhe në çdo mënyrë, të kryejmë vepra të mira për hir të Zotit pa pritur mirënjohje apo shpërblim në këtë dynja, sikurse Zoti thotë për punëdrejtët:

Ne ju ushqejmë vetëm për kënaqësinë e Allahut, dhe në këmbim nuk dëshirojmë as shpërblim e as mirënjohje (76:9).

Ajete të shumta e bëjnë të qartë se veprat e mira nuk janë të kufizuara vetëm për myslimanët, dhe as nuk janë të kushtëzuara që ai që i kryen ato të ketë pranuar Islamin; Kurani flet specifikisht për bamirësinë dhe mirësinë që i duhet dhënë prindërve, të afërmve, dhe nevojtarëve jobesimtarë. Dhe në Islam veprat e mira nuk janë të kufizuara në dobinë që iu sjellin të tjerëve në amshim; ne na kërkohet të japim ngushëllim dhe të tregojmë dhembshuri ndaj ekzistencës së thjeshtë tokësore të njerëzve dhe madje edhe të kafshëve. Zoti është i mirë dhe i dhembshur dhe e ka të dashur dashamirësinë dhe dhembshurinë dhe na shpërblen për çdo vepër të sinqertë që bëjmë, për aq kohë sa ajo është në përputhje me udhëzimin peygamberik.

Me fjalë të tjera, ne si besimtarë duhet të orvatemi që të bëjmë, të duam, dhe ta kemi zakon që të bëjmë gjithçka që është e mirë, duke filluar me detyrimet, por më pas duke shkuar përtej asaj që është

e përmendur specifiki në shpalljen hyjnore dhe përtej asaj që gjendet në normat e fik'hut. Kjo është pikërisht lëmia e shkencës së *ahlak*-ut dhe disiplinave të ndërlidhura me të të dëlirësimin të përshpirtshëm dhe etik për të cilat do të japim një shtjellim në ese të tjera në të ardhmen.

Adhurimi i Zotit Një si imperativi i parë etik

Duke iu kthyer konceptit me të cilin e nisëm këtë ese, ne përsërisim se mirësia e veprave të mira që Islami nxit është i sendërtuar mbi një themel të pashmangshëm, pa të cilin koncepti i të mirës bëhet inkoherent, dhe pa të cilin dashuria e natyrshme njerëzore për ndershmërinë, dhe mirësia që Zoti vendos në karakterin e të gjithë robërve të Tij në forma të ndryshme, bëhen të gjitha të korruptuara. Ky themel është pranimi dhe nënshtrimi ndaj të Vërtetës përfundimtare, *el-Hak*, Allahut. Kur nuk bazohen në të vërtetën përfundimtare, veprat e mira bëhen thjesht pluhur e hi (14:18).

Për ta kuptuar këtë, duhet të pranojmë se Islami është thjesht gjëja e duhur që duhet bërë në raport me Krijuesin. Si i tillë, Islami është një rrugë katërcipërisht morale e jetës – një rrugë që kërkon jo thjesht kënaqjen e një hyjnie për përmbushjen e nevojave tona sekulare, por një përgjigje totale ndaj Zotit një e të vërtetë, i cili, në amshimin e afërt e të përjetshëm, e shpërblen të mirën dhe e ndëshkon të mbrapshtën. Megjithatë, bashkëlidhja e fesë dhe adhurimit me moralin ka humbur në rastin e shumë popujve, të sotëm e të së shkuarës, të cilët i adhurojnë hyjnitë e tyre dhe kryejnë ushtrime a rituale të përshpirtshme jo për arsye morale siç është pjesëmarrja në të vërtetën dhe shprehja e mirënjohjes, por për të kënaqur nevojat e tyre sekulare, që variojnë nga dëshira e lashtë për fëmijë dhe të korra të bereqetshme, e deri në sqhetësimet moderne për lehtësim stresi, qetësi, dhe baraspeshë. Studiuesit sekularë spekulojnë se si tmerri i vdekjes, e panjohura e madhe, dhe dëshira njerëzore për të qetësuar forcat e potershme të natyrës, kanë qenë shtysat kryesore për religjiozitetin në mbarë historinë. Në realitet, këto ndjenja janë thjesht shenjat dhe përkujtuesit që Allahu ka vendosur në këtë botë dhe në zemrat tona në formën e një shtyse primordiale për përsosmëri dhe përjetësi, që me fjalë të tjera është shtysa për Zotin. Pervertimi i kësaj shtyse është ajo se si Shejtani i çon njerëzit në rrugë të shtrembër, sikurse bëri me atin tonë, Ademin: premtimi për përjetësi dhe përsosmëri ëngjëllore (fjala bie, 20:120; 7:20).

Kapitulli i parë i Kuranit, Fatihaja, na tregon tre fakte primordiale përpara se t'i drejtohet instinktit tonë për të adhuruar dhe për të kërkuar ndihmë: se Allahu e meriton të lëvdohet për shkak se Ai është më i Mëshirshmi (*rrahman, rrahim*), Mbajtësi të gjitha gjërave (*rabb*); dhe Sunduesi i gjykimit fundor moral. Vetëm më pas na thuhet që adhurimin tonë t'ia përkushtojmë ekskluzivisht Atij, dhe të mos i kërkojmë ndihmë askujt tjetër përveç Tij sepse vetëm Ai *meriton* të adhurohet dhe t'i drejtohet përgjërimit. Ideja e *hakut, të drejtës apo e të merituarës (hakk)* është një ide fundamentalisht morale. Sureja më pas përfundon me një lutje të sinqertë për udhëzim në rrugën e drejtë – sërish, një koncept moral. Si njerëz, kemi nevojë për mbrojtje dhe ngushëllim, por instikti për t'u ndjerë të sigurtë nëpërmjet arritjes së kënaqësisë së Fuqisë Përfundimtare është i ndryer në këtë sure ndërmjet dy *imperativëve moralë* njëjtazi parësor. I pari është që të pranohet të qenit madhështor dhe mirësia e Krijuesit dhe Sunduesit (bazuar mbi virtytet e vrojtimit mendjehapur, vërtetësisë, dhe mirënjohjes), dhe tjetri është t'i lutesh Sunduesit Madhështor për udhëzim dhe ndershmëri morale.

Si rrjedhojë, Islami është i preokupuar pikë së pari me të vërtetën morale, me të drejtën dhe të

padrejtën: njeriu nuk duhet t'i nënshtrohet dhe të mos adhurojë askënd tjetër përveç Zotit një e të vërtetë dhe të ndjekë Pejgamberin e zgjedhur të Zotit. Ndryshe nga botëkuptimi sekular që e ka zbrazur botën sot nga kuptimi dhe bukuria, Islami nuk e ndan *faktin* e ekzistencës nga *qëllimi* i ekzistencës – këto dy pyetje duhen bërë dhe duhet të marrin përgjigje së bashku. Ndarja e qëllimit nga fakti i jetës është thelbi i sekularizmit, dhe kur këto të dyja ndahen nga njëra tjetra, interesit sekulare marrin pashmangsjmërisht përparësi dhe manipulojnë qëllimin moral të ekzistencës. Me fjalë të tjera, nuk mund ta marrim jetën si të mirëqenë, duke vendosur se si ta jetojmë më mirë duke patur për bazë dëshirat dhe opinionet tona, duke e zbythtur çështjen e qëllimit dhe kuptimit të jetës në privatësinë e tempujve dhe shtëpive tona. Tamam tamam, ne deklarojmë që nga fillimi se Krijuesi e ka krijuar jetën me një qëllim se përmbushja e atij qëllimi është themeli i të gjitha etikave dhe të vërtetave, publike apo private qofshin.

Atëherë, përse Zoti i lë ata të cilët e mohojnë Atë, që nga Faraonët e Egjiptit të lashtë e deri te Perëndimi kolonialist e deri te fuqitë globale të sotma pafundësisht shfrytëzuese, që të lulëzojnë dhe të sundojnë tokën madje edhe teksa besimtarët të cilët qëndrojnë të kapur fort pas të vërtetës së Zotit vuajnë? Përpara se natyra vërtet imorale e modernitetit të bëhej e qartë, në veçanti përpara luftës së parë botërore, disa autorë myslimanë naivë dhe të frustruar superioritetin ushtarak të Europës ia mvishnin superioritetit të tyre moral. Ky arsyetim disfatist është fund i krye i rremë. Kurani flet për shumë përpjekje të tilla. Izraelitët ishin populli i Zotit të cilët u sprovuan në mënyrë të vazhdueshme në duart e fuqive mosbesimtare kur ata dështuan që të ruanin mesazhin e Zotit, dhe refuzuan pjesë të mësimëve hyjnore që atyre iu dukën të paleverdisshme (fjala bie, 2:85). Durimi i Zotit është pakrahasimisht më i madh se sa i yni, dhe, prandaj, Zoti është shumë më i duruar me ata të cilët janë të padrejtë karshi Atij se sa me ata të cilët janë të padrejtë karshi njëri tjetrit, ndonëse i pari është një gjynah shumë më i madh se sa i dyti. Ky është kuptimi i thënies së famshme të dijetarëve se “Zoti i jep kohë jobesimtarëve të cilët zotërojnë virtytin e drejtësisë, por atyre të cilët janë besimtarë por që janë reciprokisht të padrejtë.” Sepse është me vend që ata të cilët e kanë udhëzimin e Zotit të merren në llogari që në këtë botë për t’iu përkujtuar atyre që të respektojnë detyrimin e tyre ndaj Zotit dhe ndaj njerëzimit, dhe se atyre të cilët nuk kanë akses në kumtin e Zotit t’iu jepet kohë derisa kumti të vijë tek ata. Dhe Allahu e di më së miri.

[1] Christine Tamir, Aidan Connaughton, dhe Ariana Monique Salazar, “The Global God Divide: People’s Thoughts on whether Belief in God Is Necessary to Be Moral Vary by Economic Development, Education and Age,” Pew Research Center, 20 korrik 2020, <https://www.pewresearch.org/global/2020/07/20/the-global-god-divide/>. Vëreni se të dhënat nuk e përkrahin pretendimin e autorëve se ekonomia është shpjegimi për këtë ndarje: Turqia (75%), SHBA (44%), Kanadaja (26%), dhe vendet e Europës lindore (që variojnë nga 14 deri në 50%) lënë të kuptohet se kjo histori është më e ndërlikuar.

[2] David Graeber, *Debt: The First 5,000 Years* (New York: Melville House Publishing, 2011), 315, 344.

[3] James G. Speth, *The Bridge at the Edge of the World* (Yale University Press, 2008), xx-xxi, 50. Autori, ish dekan i Yale Forestry dhe një ambientalist i dorës së parë, e përmbledh atë çka thonë

autoritetet kryesore mbi këtë temë dhe konkludon se nevojitet absolutisht një rishikim i plotë i stilit perëndimor të jetës, kapitalizmit, dhe madje edhe ndërgjegjes, dhe rekomandon kthimin në një jetë që është thellësisht e orientuar nga bashkësia dhe me nuance të forta shpirtërore (199).

[4] Ka mënyra të shumta për t'i shpjeguar këto fakte. Kjo shifër citohet në John L Seitz, *Global Issues: An Introduction* (Hoboken, NJ: Wiley Blackëell, 2001). Një tjetër formulim jepet këtu: "Use It and Lose It: The Outsize Effect of U.S. Consumption on the Environment," *Scientific American*, September 14, 2021, <https://www.scientificamerican.com/article/american-consumption-habits/>. Aty thuhet se "një fëmijë i lindur në Shtetet e Bashkuara do të krijojë trembëdhjetë më tepër dem ekologjik përgjatë gjithë jetës së tij apo të saj se sa një fëmijë i lindur në Brazil."

[5] Speth, *Bridge at the Edge*, 50.

[6] Hadithi *innam? bu?ithtu li-utammim mak?rim al-akhl?q* (disa versione e zëvendësojnë *mak?rim me ?usn* dhe të tjerë me *??lih*, pa ia ndryshuar kuptimin) përcillet nga Imam Maliku në veprën e tij *Muwa??a'* (Kit?b ?usn al-Khuluq) pa *isn?d*, nga Imam Ahmed ibn Hanbeli në *Musnad* (no. 8952; ed. Shu?ayb al-Arna'??), nga al-Bukhar? në

al-Adab al-Mufrad (no. 207), dhe është cilësuar *?a???* nga dijetarë të shumtë, përfshirë al-Alb?n?, Ibn ?Abd al-Barr, dhe të tjerë.

[7] *Sunan Abu Dawud*, no. 5225, i cilësuar *?a???*; pjesa e parë e hadithit transmetohet gjithashtu edhe në *Sahih Muslim*, no. 17.

[8] *Sahih al-Bukhari*, no. 3493.

[9] Ibn ?ajar, *Fat? al-B?r?* (Beirut: D?r al-Ma?rifa, 1379), 6:529, si shpjegim për *Sahih al-Bukhari*, no. 3493.

[10] Stephen Halliwell, *Plato: Republic Book V* (Oxford: Oxford University Press, 1993), 3–4, 16.

[11] Për shembull, shiko Stephen Mitchell dhe Peter Van Nuffelen, ed., *One God: Pagan Monotheism in the Roman Empire* (Cambridge: Cambridge University Press, 2010), në veçanti kontributet nga Michael Frede dhe Alfons Fürst mbi monoteizmin pagan grek dhe romak pa monolatri: domethënë, besim në një hyjni supreme bashkë me adhurimin e shumë perëndive më të vogla, një situatë kjo mjaft e ngjashme me xhahilijetin para Islamit. Pjesa më e madhe e këtyre monoteizmave filozofikë, megjithatë, mbruanin një nocion deist të Zotit i cili nuk ka fuqi për të ndërhyrë në botë, dhe që është i pajtueshëm me idhujtarinë, dhe të dyja këto nocione Islami i korrigjoi.

[12] Argumenti im nuk është që të them se këta filozofë ishin përnjëmend monoteistë, pasi ky mbetet një pretendim i diskutueshëm. Ata si Frede në shënimin paraardhës të cilët e ngrejnë këtë pretendim (që është bindës për këtë autor) thonë vetëm se Platoni dhe Aristoteli e filozofuan rrugën e tyre drejt supremacisë përfundimtare të një Zoti të vetëm, por ata nuk iu kundërvunë adhurimit të idhujve.

[13] Për një perspektivë perëndimore mbi monoteizmin hindu, shiko Gavin Flood, *Hindu Monotheism* (Cambridge: Cambridge University Press, 2020).

[14] Ibn Taymiyya, *Majm?? Fat?wa* (Medina: Majma? al-Malik Fahd, 1995), 3:295.

- [15] Robert Coles, *The Spiritual Life of Children* (Boston: Houghton Mifflin, 1990).
- [16] Darel E. Paul, *From Tolerance to Equality: How Elites Brought America to Same-Sex Marriage* (Waco, TX: Baylor University Press, 2019), në të cilin një historian i dorës së parë argumenton se si një klas e vogël e pasur manaxheriale në SHBA ka udhëhequr mësymjen për të ndryshuar moralin seksual të Amerikës.
- [17] Alasdair MacIntyre, "The Claims of *After Virtue*," në *The MacIntyre Reader*, ed. Kelvin Knight (Notre Dame, IN: University of Notre Dame Press, 1998), 69.
- [18] MacIntyre, "Claims of *After Virtue*," 69–71.
- [19] Steven D. Smith, *The Disenchantment of Secular Discourse* (Cambridge, MA: Harvard University Press: 2010), 38. Termat *liberal* dhe *secular* unë i paraqes me qëllim. Filozofia etika dhe politike dominante e kohës sonë është liberalizmi, i cili mbron idenë se liritë dhe të drejtat individuale kanë përparësi në raport me çdo pretendim për të vërtetën. Sekularizmi është ideja se feja duhet të largohet nga jeta publike. Liberalizmi ka nevojë për sekularizmin, por sekularizmi nuk ka nevojë për liberalizmin, dhe ka një numër shoqërisht sekulariste joliberalë si Rusia, Kina, dhe disa diktatura të Lindjes së Mesme. Për shkak të hegjemonisë së liberalizmit dhe sekularizmit, këto qëndrime efektivisht ateiste karshi normave etike shpeshherë bashkëndahen dhe mbrohen nga njerëz fetarë.
- [20] Kjo dukuri eksplorohet në artikullin e profesorit të Vanderbilt University, William Franke, "The Deaths of God in Hegel and Nietzsche and the Crisis of Values in Secular Modernity and Post-Secular Postmodernity," *Religion and the Arts* 11 (2007), 215.
- [21] Friedrich Nietzsche, *The Gay Science* [përkthim i origjinalisht në gjermanisht, *Die fröhliche Wissenschaft*] (Leipzig: E. W. Fritsch, 1887), 181.
- [22] Sung Ho Ku, "Max Weber," në *Stanford Encyclopedia of Philosophy*, 24 gusht, 2007, përditësuar më 27 nëntor, 2017, <https://plato.stanford.edu/entries/weber/>.
- [23] Max Weber, "Science as a Vocation" në *From Max Weber* (Oxford University Press, 1946 [1919]), 149.
- [24] Mirza Safwat, "Why Modern Atheists Are Mushriks," *Islam 21C*, 25 tetor, 2021, <https://www.islam21c.com/islamic-thought/why-modern-atheists-are-mushriks/>.
- [25] Shiko Biana Bosker, "Why Witchcraft Is On the Rise," *The Atlantic*, March 2020, <https://www.theatlantic.com/magazine/archive/2020/03/witchcraft-juliet-diaz/605518/>. Por më përgjithësisht, kjo ka ndodhur që nga shfaqja e Iluminizmit modern, sikurse është studiuar kjo në Jason Storm, *The Myth of Disenchantment: Magic, Modernity, and the Birth of the Human Sciences* (Chicago: University of Chicago Press, 2017).
- [26] "Peru: Ancient Mass Grave of 140 Sacrificed Children Found," *Aljazeera*, 4 prill, 2018, <https://www.aljazeera.com/news/2018/4/28/peru-ancient-mass-grave-of-140-sacrificed-children-found>.
- [27] Një rast i jashtëzakonshëm është i dokumentuar këtu: Nat Hentoff, "A Professor Who Argues for

Infanticide,” *Washington Post*, 11 shtator, 1999, <https://www.washingtonpost.com/archive/opinions/1999/09/11/a-professor-who-argues-for-infanticide/ce7dc81-3775-4ef6-bfea-74cd795fc43f/>. Një justifikim më tipik ofrohet këtu: “Abortion is the cornerstone of women’s existential equality, an inalienable part of which is sexual freedom.” Judith Levine, “Hillary Clinton and the Unqualified Right to Abortion,” 31 tetor, 2016, <https://bostonreview.net/articles/judith-levine-hillary-clinton-abortion/>.

[28] Shiko Jared Diamond, *The World Until Yesterday: What Can We Learn from Traditional Societies?* (New York: Penguin Books, 2013).

[29] Richard Weikart, *Hitler’s Ethic: The Nazi Pursuit of Evolutionary Progress* (New York: Palgrave, 2009). Shiko gjithashtu, Michael Rosenëald, “Hitler Hated Judaism. But He Loathed Christianity, Too,” *Washington Post*, 20 prill, 2019, www.washingtonpost.com/history/2019/04/20/hitler-hated-judaism-he-loathed-christianity-too/.

[30] Jonathan Glover, *Humanity: A Moral History of the Twentieth Century* (New Haven, CT: Yale University Press, 2012). Vlerësimet janë që sovjetikët vranë 62 milionë njerëz (237). Në Kinë, përveç spastrimeve të regjimit, uria e shkaktuar nga ideja “fisnike” e Hapit të Madh Përpara vrau rreth njëzet tridhjetë milionë njerëz (284), kurse për Revolucionin Kulturor, vlerësimet luhaten ndërmjet disa qindar mijëra dhe njëzet milionë.

[31] “Al-Qaeda Disavows ISIS Militants in Syria,” BBC, 3 shkurt, 2014, <https://www.bbc.com/neës/ëorld-middle-east-26016318>.

[32] Shiko, për shembull, letrat e ndryshme që i janë dërguar kreut të IS el-Bagdadi, “Scholars’ Open Letter Adds to Chorus of Muslim Leaders Condemning ISIS,” *Slate*, September 25, 2014, <https://slate.com/news-and-politics/2014/09/muslims-scholars-open-letter-to-isis-baghdadi-caliphate-s-actions-against-qur-an-islam.html>.

[33] Rahul Mahajan, “We Think the Price Is Worth It,” FAIR, November 1, 2001, <https://fair.org/extra/we-think-the-price-is-worth-it/>

[34] Katër shkollat teologjike në Islam shpjegohen në mënyrë të shkëlqyer dhe të barazpeshuar në Sherman A. Jackson, *Islam and the Problem of Black Sufering* (Oxford: Oxford University Press, 2009).

[35] Ibn al-Qayyim, *l’la?m al-muwaqqi’i?n* (Beirut: Dar al-Kutub al-`Ilmiyya, 1991), 3:11.

Date Created

02/03/2022

Author

erasmusi